



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.66/2019
Prishtinë, më 6.6.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Lutfi Zharku, Liburn Aliu, Muharrem Nitaj, Veton Berisha, Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Glauk Konjufca dhe Memli Krasniqi, anëtarë.

Të ftuar: Valon Prestreshi, kryetar i Bordit të AKK-së dhe Ilir Shala, kryeshef ekzekutiv i NP KOSTT.

Pjesëmarrës të tjerë: Ahmet Krasniqi, Bekim Millaku dhe Kushtrim Xhemaili, AKK; Kadri Kadriu dhe Visar Hoxha, KOSTT; Blerta Bejtullahu, Zyra e BE-së; Lirdon Gashi, SEEF; Violeta Haxholli, Agnesa Haxhiu dhe Ardiana Tusha, KDI; Vatra Qehaja, GPLVV; Marigona Bajrami, GPPSD.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi, Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 28.5.2019;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës – AKK për vitin 2018;
4. Njoftim nga përfaqësues të KOSTT-it, lidhur me sfidat e paraqitura për këtë ndërmarrje publike, pas miratimit të Ligjit për paga;
5. Shqyrtimi i raportit me rekomandimet për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Dardan Sejdiu, kërkoi që pika 5 e rendit të ditës, të kalojë në pikën 4 të rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga deputeti Dardan Sejdiu.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.5.2019

Procesverbali i mbledhjes së datës 28.5.2019, u miratua pa vërejte

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës – AKK për vitin 2018

Kryetarja theksoi se për sot e kemi në shqyrtim raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2018 dhe për ta prezantuar këtë raport i kemi ftuar përfaqësuesit e AKK-së. Për prezantimin e raportit, kryetarja ia dha fjalën kryetarit të AKK-së, z. Valon Prestreshit.

Valon Prestreshi, kryetar i Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK), theksoi se Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, si institucion i pavarur, ka bërë një progres të suksesshëm gjatë vitit 2018. Viti që lemë pas, përkon me shumë aktivitete të ndërmarra nga autoriteti, aktivitete të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës. Përveç tri fushave, të cilat janë kompetencë e autoritetit, (marrëveshjet e ndaluara, abuzimi me pozitën dominuese dhe përqendrimet) gjatë vitit 2018, ne kemi qenë aktivë edhe në fushën e avokimit, në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të brendshëm. Ai tha se gjatë vitit 2018, autoriteti ka finalizuar kornizën legjislative të funksionimit të tij dhe njëkohësisht në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ka punuar në hartimin e koncept-dokumentit për Ligjin e ri për mbrojtjen e konkurrencës. Gjithashtu, autoriteti ka ndryshuar strukturën organizative të tij, fillimisht duke ngritur numrin e inspektorëve hetues dhe duke krijuar divizione të 4 fushave kryesore që trajtohen nga autoriteti, me kusht që rastet të fasilitohet në mënyrë të drejtë dhe profesionale. Ai theksoi se autoriteti ka iniciuar raste të tregjeve të ndryshme. Një nder çështjet që autoriteti i ka adresuar dhe atakuar është udhëzimi administrativ për përcaktimin e kushteve të homologimit të automjeteve. Me ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe në bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe vendas, autoriteti ka filluar të trajtojë raste të “Bid Rigging” (manipulimin me oferta) në tenderët publikë, më konkretisht, në tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë. Më tej, potencoi se autoriteti, bazuar në fakte të qëndrueshme, ka iniciuar procedurë hetimore kundrejt disa kompanive që kanë ofruar çmime joreale tregtare në tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë. Rasti tjetër i trajtuar nga autoriteti është kontrata publike për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile, të marra nga organet shtetërore nga operatori ekonomik “Telekomi i Kosovës”. Autoriteti mbi bazën e fakteve të qëndrueshme ka iniciuar procedurë hetimore kundrejt pjesëmarrësve në këtë kontratë. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, gjithashtu ka trajtuar dhe ka përfunduar një ndër rastet më voluminoze që ka pasur gjatë vitit 2018, rasti i marrëveshjes së IPKO-s dhe DIGITALB. Ndërsa, në fund të vitit 2018, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka filluar monitorimin e tregut të derivateve të naftës, pas një reagimi të madh të qytetarëve dhe mediave mbi dyshimin e një marrëveshjeje të ndaluar ndërmjet operatoreve që afardojnë në këtë treg. Në të gjitha rastet ka pasur kujdes që komunikimi të jetë sa më transparent dhe i përshtatur në përputhje me karakteristikat kryesore të çdo grupi interesi. Misioni unik i autoritetit, si garantues i konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, do të mbetet

prioriteti madhor i punës sonë në vitin 2019. Prandaj, autoriteti do të mbetet një avokat i përkushtuar i konkurrencës së lirë dhe interesave të konsumatorit, duke besuar se vetëm në këtë mënyrë do të përmbushë synimin final për më shumë zhvillim dhe mirëqenie për të gjithë.

Kryetarja parashtoi disa pyetje për përfaqësuesit e AKK-së, si vijon: A mund të na shpjegoni se cilat tregje janë monitoruar dhe çka ka rezultuar nga monitorimi i këtyre tregjeve? Pse duhet ligj i ri, cilat janë pjesët/fushat kryesore që do të ndryshohen apo plotësohen nga ligji ekzistues? Në faqen 11, marrëveshjet e ndaluara/kartelet, janë paraqitur rastet e trajtuara gjatë vitit 2018. Në këtë pjesë, edhe pse numri i rasteve është i vogël, do të duhej të paraqitej fillimisht se çfarë rrethanash e kanë përcjellë shtyllën e marrëveshjeve të ndaluara, në përgjithësi, në cilët sektor ekonomik është më shumë i shtrirë ky fenomen, si dhe krahasimin me vitet paraprake nëse ka rënie apo ngritje të numrit të marrëveshjeve të ndaluara, numrit të rasteve të dyshuara apo të ngritura nga palët tjera. E mandej, të paraqiten rastet veç e veç, siç janë në raport. E njëjta situatë është edhe te pjesa, abuzimi me pozitën dominuese, si dhe te përqendrimet/bashkimet e ndërmarrjeve. A ka bërë autoriteti hulumtime me iniciativë të vet, në ndonjë sektor apo ndërmarrje, nëse ka abuzim me pozitën dominuese? A ka kapacitete të mjaftueshme autoriteti që të përfaqësohet në gjykata dhe a përfaqësohet vetë apo nga avokatë të kontraktuar? A nënkupton kjo që statuti nuk është i harmonizuar me ligjin në fuqi, si dhe pse nuk është sjellë në Kuvend nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës deri më tani, që të miratohet statuti i ri i harmonizuar? Në faqe 39, te sfidat dhe rekomandimet, është thënë: (8) Sfidë e autoritetit mbeten kontrollimet e paparalajmëruara ndaj ndërmarrjeve dhe konfiskimi i fakteve; dhe (10) Sfidë mbetet vendosja e gjobave ndaj shkelësve të konkurrencës, në mënyrë meritore. Pse janë sfidë dhe a është e mundur që autoriteti t'i zgjidhë këto sfida? Ligji në fuqi, a paraqet pengesa në zbatim të detyrimeve ligjore të AKK-së dhe të rregullimit të fushës së mbrojtjes së konkurrencës?

Liburn Aliu, pyeti për rastet e trajtuara: A kanë ardhur si rezultat i ankesave nga palët e jashtme apo keni iniciuar ju vet si autoritet? Te çështje e homologimit të automjeteve, çfarë përgjigje keni marrë nga Ministra e Infrastrukturës? Për rastin e kontratës publike për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile Vala, të marrë nga organet shtetërore nga operatori ekonomik “Telekomi i Kosovës”, me të drejtë e keni ngritur këtë çështje të moslejimit të konkurrencës së lirë, ndërsa me operatorët e tjerë privatë, çka ka ndodhur?

Muharrem Nitaj, tha se në fund të vitit 2018, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka filluar monitorimin e tregut të derivateve të naftës dhe ende kjo çështje nuk ka përfunduar. Pse ju është dashur kaq shumë kohë për ta mbyllur këtë rast dhe a keni ndonjë rast që është dënues ndonjë kompani që merret me tregun e derivateve të naftës?

Dardan Sejdiu, tha se ky raporti i vitit 2018 është i njëjti në përmbajtje me atë të vitit 2017, por vetëm ka ndryshuar te monitorimi i tregut të derivateve të naftës dhe inicimi i hapjes së liberalizimit të homologimit të automjeteve. Pra, edhe për këto dy çështje, ende nuk kemi raporte të sakta se çka ka ndodhur konkretisht dhe kërkoj sqarime. Çka po ndodh me arkat fiskale? Sa tema i trajtoni brenda vitit për gjitha çështjet? Ndërsa, sa përket konkurrencës në prokurimin publik, ligji ia lejon shtetit të zgjedhë një operator të blejë për furnizimin e nevojave publike nga operatori publik.

Lutfi Zharku, pasi që keni kundërshtuar udhëzimin administrative për përcaktimin e kushteve të homologimit të automjeteve, të miratuar nga Ministra e Infrastrukturës, tani, cilat masa mund t'i merrni ju si AKK, nëse institucionet nuk e zbatojnë rekomandimin e juaj? A ka ndonjë lëndë që keni fituar në gjykata?

Valon Perstreshi (AKK), duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve, theksoi se sa i përket çështjes së pozitës dominuese, ligji e lejon pozitën dominuese, por nuk duhet të abuzohet me të. Te homologimi i automjeteve, tha kemi pozitë dominuese, sepse çmimi është përcaktuar nga Ministra e Infrastrukturës dhe udhëzimi administrative për përcaktimin e kushteve sipas MI-së është bazuar në ligj, ndërsa AKK-ja e ka kundërshtuar këtë udhëzim administrativ dhe e vetmja masë që mund të merret, është dërgimi i kësaj lënde në gjykatë. Deri më tani, AKK i ka humbur të gjitha lëndët në gjykata, edhe pse në të gjitha rastet jemi në proces të ankimit.

Dardan Sejdiu, tha se udhëzimi administrativ për përcaktimin e kushteve të homologimit të automjeteve, i miratuar nga Ministra e Infrastrukturës, nuk mund të jetë mbi Kushtetutën dhe as mbi ligjin, por ju si autoritet keni obligim ta trajtoni, deri në fund, në mënyrë që të hapet rruga për liberalizimin e tregut. Pra, ekziston baza ligjore dhe keni të drejtë t'u rekomandoni instancave më të larta për ta shfuqizuar këtë udhëzim. Po ashtu, potencoi se edhe për pozitë dominuese në treg, që janë nga sektori privat, nëse keni konstatime se po ka shkelje, pse nuk po veproni?

Valon Prestreshi (AKK), tha se është çështje e ministrisë përkatëse se a do të bëjë liberalizimin e tregut të homologimit të automjeteve.

Ahmet Krasniqi (AAK), foli sa i përket Ligjit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës dhe për nevojën e nisjes së plotësim-ndryshimit të këtij ligji. Ligji aktual duhet të fillojë të plotësohet dhe të ndryshohet, pasi që fusha e konkurrencës është një sektor që ka avancime të vazhdueshme dhe të shpejta dhe ligji duhet t'i përshtatet rrethanave të tregut të konkurrencës së lirë. Ne kemi 15 deri 16 vërejtje që duhet të plotësohet dhe të ndryshohet ligji. Lidhur me udhëzimin administrativ për përcaktimin e kushteve të homologimit të automjeteve, tha se është në kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, sa i përket caktimit të shumës së çmimit, por kjo kontratë përfundon në këtë vit dhe është çështje dhe e drejtë e shtetit se a do ta ndërpresë, sepse kjo kontratë ekzistuese e ka licencuar vetëm një operator dhe nuk e ka lejuar hapjen e konkurrencës së tregut. Për pozitën dominuese, theksoi se mund të fitohet me treg të lirë ose kur është interes publik i shtetit, që ta lejojë një kompani që të ketë një pjesë të tregut për çështje të caktuar të interesit të shtetit, por keqpërdorimi ndodh kur ka ulje dhe rritje të çmimit, pa ndonjë arsyetim.

Bekim Millaku (AKK), sqaroi se sa i përket monitorimit të tregut të derivateve të naftës, kjo çështje na është paraqitur nga fundi i vitit të kaluar, në 2018 dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, menjëherë i ka filluar procedurat me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, por në ligj është një afat kur duhet t'u përgjigjen kërkesave të AKK-së, kompanitë që merren me tregun e derivateve të naftës dhe këto të dhëna që dalin do t'i analizojnë mirë deri në detaj për një periudhë 3 mujore. Pastaj, do të dalim me një raport, se ku janë të gjeturat. Përfaqësimin në gjykata, tha se AKK-ja e përfaqëson vetë, me stafin e saj, por që kemi humbur shumë lëndë, për

shkaku se dy gjyqtarë për të njëjtën lëndë kanë vendosur në mënyrë të ndryshme. Ndërsa, sa i përket tregut të arkave fiskale, tha se pasi kemi shqiptuar dënime, ka filluar hapja e tregut.

Dardan Sejdiu, pyeti: Pasi që është liberalizuar tregu për arkat fiskale, cila është përqindja në treg, a ekziston pozita dominuese për ndonjë kompani?

Bekim Millaku (AKK), tha se është hapur mundësia që kompanitë të futen në treg dhe nuk kemi përqindje të saktë, por është lejuar mundësia e liberalizimit të tregut dhe lejuar konkurrenca e lirë.

Muharrem Nitaj, parashtroi disa pyetje: lidhur monitorimin e tregut për derivatet e naftës që 8 muaj është kjo çështje duke u hetuar, pse se nuk keni dërguar në Gjykatë? Po thoni që keni dërguar te Ministra për Infrastrukturë rekomandimin për shfuqizimin e udhëzimit administrativ, pse nuk e keni shtyrë më tutje për ta dërguar vetë në Gjykatën Kushtetuese? Pse nuk i keni bërë publike shkeljet e udhëzimit administrativ që bie ndesh me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës? Fundja, pasi që nuk po zbatohet rekomandimi juaj, ndoshta duhet edhe të jepni dorëheqje, që ta sensibilizoni këtë çështje.

Valon Prestreshi (AKK), sqaroi për monitorimin e tregut për derivatet e naftës, kjo çështje duhet trajtuar më shumë profesionalizëm dhe ende nuk kemi ardhur te përfundimi i saktë, si dhe kemi të drejtë për të hetuar deri më 10 muaj, kështu që jemi brenda afatit ligjor. Për çështjen e homologimit të automjeteve, tha se si autoritet iu kemi drejtuar të gjitha institucioneve, edhe juve si komision iu kemi njoftuar, por Kushtetuta nuk na lejon t'i kontestojmë vendimet e Ministrisë së Infrastrukturës. Po ashtu, kemi kërkuar edhe nga Avokati i Popullit, që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, për këtë çështje.

Pas diskutimeve, komisioni unanimisht, nxori këtë:

Konkluzion

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës të dërgojë të dhëna shtesë, lidhur me çështjen e homologimit të automjeteve.

4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike

Kryetarja theksoi se kryesues i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike është deputeti Dardan Sejdiu, të cilit ia dha fjalën për të e paraqitur raportin me rekomandime të Ligjit për energjinë elektrike.

Dardan Sejdiu, në cilësinë e kryesuesit të grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike, në fillim, kërkoi ndjesë që si kryesues i këtij grupi e ka vonuar monitorimin e këtij ligji. Më tej, tha se grupi punues ka zhvilluar disa aktivitete gjatë mbikëqyrjes, ku kemi nxjerrë 10 rekomandime të sakta dhe të qarta, ku i rekomandojmë çdo institucioni veç e veç, për të kryer obligimet që dalin nga Ligji për energjinë elektrike. Po ashtu, njoftoi komisionin se për këtë monitorim, grupi i punës ka bashkëpunuar ngushtë me OJQ

INDEP, të cilët i falënderoi për analizën e bërë enkas për grupin e punës. Pastaj i prezantoi rekomandimet si vijon:

1. Qeveria e Kosovës obligohet:

- a) Në afat prej 6 (gjashtë) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve, të bëjë plotësim-ndryshimin e Ligjit nr.05/L-085 për energjinë elektrike. Ky plotësim-ndryshim duhet të reflektojë sfidat si në vijim: sfidat në zbatim; sfidat në tregun e hapur; qartësimin e kompetencave në mes të aktorëve në zbatim të ligjit; saktësimin se kur është e lejuar dhe kur jo vendosja e obligimit të shërbimit publik, në mënyrë që të ruhet konkurrenca e lirë; harmonizimin e Ligjit nr.05/L-085 për energjinë elektrike, me Ligjin nr.05/L-081 për energjinë, në mënyrë që skema e mbështetjes për burime të ripërtëritshme të energjisë të jetë e qartë dhe kompetencat të jenë qartësisht të ndara në mes ZRRE-së dhe Qeverisë, si dhe harmonizimin me Ligjin nr.06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit.
- b) Në afat prej 3 (tre) muajsh, nga miratimi i këtyre rekomandimeve, të sigurohet se po respektohet neni 9 mbi rezervat e obligueshme të lëndëve djegëse. Po ashtu, informatat që i merr nga prodhuesit e licencuar duhet t'i bëjë publike dhe duhet t'i monitorojë rregullisht aktorët në treg, se a po e zbatojnë këtë obligim ligjor.
- c) Më së largu, deri në fund të vitit 2019, të krijojë fondin për konsumatorët në nevojë - kriteret duhet të jenë të qarta, me indikatorë të matshëm dhe procesi duhet të jetë transparent.

2. Zyra e Rregullatorit të Energjisë obligohet:

- a) Të përcaktojë afate të qarta për Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut.
- b) Të ofrojë më shumë llogaridhënie dhe transparencë në vendimet e bordit.
- c) Të sigurohet se KESCO po zbaton obligimet që i ka ndaj furnitorëve të rinj në treg dhe të bëjë një monitorim të rreptë gjatë kryerjes së aktiviteteve të saj, për të evituar keqpërdorimin e pozitës dominuese dhe për të hapur tregun.
- d) Në afat prej 3 (tre) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve, të krijojë skemën e certifikatave të origjinës dhe të sigurohet se po zbatohet.
- e) Në afat prej 3 (tre) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve, të miratojë rregullat për sistemet e mbyllura të shpërndarjes.
- f) Në raportin vjetor të reflektojë monitorimin për zbatimin e licencës nga ana e KEDS-it, sa i takon obligimeve ndaj palëve të tjera në treg, përfshirë obligimin për qasje në infrastrukturë, si dhe ndërprerje të paarsyeshme të furnizimit me energji.
- g) Të sigurohet se të gjithë konsumatorët, të rinj dhe ata ekzistues, po e nënshkruajnë kontratën me operatorin e furnizimit, të atillë që është qartësisht e kuptueshme për konsumatorin.

Pas diskutimeve, komisioni unanimisht, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike.

5. Njoftim nga përfaqësues të KOSTT-it, lidhur me sfidat e paraqitura për këtë ndërmarrje publike, pas miratimit të Ligjit për paga

Kryetarja theksoi se sa përket kësaj pike të rendit të ditës, për t'i paraqitur sfidat e ndërmarrjes publike, pas miratimit të Ligjit për paga, me kërkesë të tyre, e kemi ftuar përfaqësuesin e KOSTT-it, ku ia dha fjalën të kryeshefit të KOSTT-it, z. Ilir Shala.

Ilir Shala (KOSTT), i njoftoi anëtarët e komisionit, lidhur me shqetësimet e KOSTT-it, që mund të përballen ndërmarrje publike, pas miratimit të Ligjit për paga. Më tej, tha se kur është miratuar Ligji për paga, e kemi pasur një kërkesë, drejtuar komisionit përkatës të Kuvendit, por në atë kohë nuk është marrë parasysh për pasojat që mund t'i ketë ndërmarrja publike KOSTT dhe këtë çështje do ta adresojmë edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Po ashtu, foli për rëndësinë dhe rolin që e ka ndërmarrja KOSTT, pastaj e paraqiti kërkesën që Ligji për paga ka dëmtuar mjaft ndërmarrjen KOSTT, sepse me zbatimin e koeficienteve, të paraparë me Ligjin për paga nga 1 deri në 7, mund t'i demotivojë punëtorët e KOSTT-it, që janë shumë profesionalë dhe kjo i bie që 53% t'iu zvogëlohet rroga të gjithë punëtorëve. Po ashtu, kërkoi nga komisioni që mundësisht ta përshpejtojë në seancën e Kuvendit zgjedhjen e Bordit të KOSTT-it, sepse ka një kohë të gjatë që ndërmarrja KOSTT, ka mbetur pa bord dhe shumë vendime që lidhen me zhvillimin e ndërmarrjes KOSTT, kanë mbetur pa u realizuar.

Pas diskutimeve, komisioni unanimisht, vendosi dhe nxori:

Konkluzion

Komisioni vendos, lidhur me këtë çështje, në mbledhjen e radhës.

6. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Kryetarja, sipas propozimit të projektit të KDI-së, kërkoi nga anëtarët e komisionit që të vizitohet Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, lidhur me ndërrimin e kodit telefonik shtetëror. Kjo çështje ka qenë me Marrëveshjen me Serbinë, që është arritur në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi, që është zhvilluar në Bruksel. Për kohën, kur do ta realizojmë vizitën, do të njoftoheni nga stafi i komisionit.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetares.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA